

Regj.nr.11598/2011

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË GJILAN, sipas gjyqtares Mirvete Alidemi dhe sekretares juridike Hamide Zymberi, duke vendosur në lendën për kundërvajtje ndaj të pandehurit Omer Daku nga Gjilani, për shkak të veprës kundërvajtës – mosdeklarim i rregullt vjetor i pasurisë të parashikuar nga neni 6 paragrafi 2 dhe i ndëshkuar sipas nenit 16 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarve të Lartë Publik Nr. 03/L-151 të dt. 11 shkurt 2010, e sipas kërkesës për kundërvajtje të Agjencisë Kundër Korrupsionit nga Prishtina NR. 01-3209/11 të dt. 14.07.2011, pas mbajtjes së séances gjyqësor, e në bazë të nenit 73, 74, dhe 195 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më dt. 30 janar 2012, mori këtë:

A K T V E N D I M

I pandehur Omer Daku, nga babai Zejnullah, i lindur më dt. 14. 10.1967, me vendbanim në Gjilan, rruga “ 7 Shtatori ” nr. 19, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, Nënkyetar i Komunës së Gjilanit, i martuar- baba i dy fëmijëve, me gjendje të mesme ekonomike, më parë i pa denuar, për vepra të kësaj natyre,

Ë S H T Ë P Ë R G J E G J Ë S

Sepse duke qenë si zyrtar i lartë publik në pozitë e Nënkyetarit të Komuns së Gjilanit, nuk e ka bërë deklarimin e rregullt vjetor të pasurisë në afatin e caktuar ligjor deri më 31 mars 2011 të kërkuar nga Agjencioni Kundër Korrupsionit dhe të paraparë me ligj,


-me qka ka kryer veprë kundërvajtëse –mosdeklarim i rregullt vjetor i pasurisë të parashikuar nga neni 6 paragrafi 2 dhe i ndëshkuar sipas nenit 16 paragrafi 1 pika 11 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarve të Lartë Publik Nr. 03/L-151 të dt. 11 shkurt 2010,

Prandaj, në bazë të dispozitës së cekur më lartë gjykata e shpallë përgjegjës dhe e

D Ë N O N

Me DËNIM GJOBE në shumë prej 300(treqindë)Euro, të cilin denim i pandehuri është i obliguar të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë ditësh) nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, në të kundërtën ky denim mundë të zëvendësohet me denim burgu, ku për qdo 15.00(pesëmbëdhjetë) Euro do të llogaritet nga një ditë burgu.

-obligohet i pandehuri që në emër të paushalit gjyqësor ti paguaj kësaj gjykate shumë prej 5 euro në afat të njejt si edhe gjobën.



Agjencia e Gjiatës Komiteti Gjyqësor i Prishtinës, në emër të Gjykatës së Gjiatës, Nr. 3209/11 të dt. 14.07.2011 për fillimin e procedurës për kundërvajtje ndaj të pandehurit Omer Daku nga Gjiatë, nën shkak të veprës kundërvajtëse- mosdeklarim i rezultit vjetor i punës për parashikimin e pasurisë dhe dhuratave të dhuruarit, sipas paragrafi 1 pika 11 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarve të Lartë Publik Nr. 03/L-151 të dt. 11 shkurt 2010, dhe ka kërkuar që i njëjti të shpallet përgjegjës dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjyqtarja, shqyrtoi kërken e parshtruara dhe konstatoi që e njëjtat është e ligjshme si dhe zhvilloi procedurën kundërvajtëse me dëgjimin e të pandehuritn Omer, i cili në mbrojtjen e dhënë në këtë gjykatë në tërsi e pranoi kundërvajtjen e cila i vebet në barrë duke u arsyetuar që për shkak të angazhimeve që kishte në punë nuk ka mundur ta plotësoj formularin menjëherë dhe ditën e fundit kur ka filluar ta plotësoj formularin e ka vërejtur që duhet edhe nënshkrimi i bashkëshortes së tij e që në formularët e vitit paraprak nuk ishte kërkuar dhe për këtë është vonuar dhe nuk ka mundur ta plotsoj në afatin ligjor. Poashtu deklaroi që pasuria e tij nuk ka ndryshuar, por është e njëjtë ajo që e ka deklaruar në vitin 2010.

Meqë i pandehuri e pranoi kundërvajtjen e cila i vebet në barrë nuk pati nevojë të kërkohej prova shtesë si dhe që deklarata e tij ka mbështetje edhe në shkresat tjera në lëndë nga të cilat edhe u vërtetua që i njëjti ka kryer veprën kundërvajtëse – mosdeklarim i rregullt vjetor i pasurisë të parashikuar nga neni 6 paragrafi 2 dhe i ndëshkuar sipas nenit 16 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarve të Lartë Publik Nr. 03/L-151 të dt. 11 shkurt 2010, për të cilën iu shqiptua denimi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke konsideruar që edhe me këtë lloj të denimit do të ndikoj që në të ardhmen mos të përsërisë vepra të kësaj natyre.


Vendimi mbi paushallin gjyqësor është mare ne mbështetje të nenit 109 të Ligjit mbi Kundërvajtjet.

Nga të cekurat e mësipërme u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

VENDOSUR NË GJYKATËN PËR KUNDËRVAJTJE NË GJILAN

Më dt. 30 janar 2012

Sekretarja Juridike,
Hamide Zeqiri



Këshilla Juridike: Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, në Gjykatën e Lartë Për Kundërvajtje në Prishtinë. Ankesa dorzohet përmes kësaj Gjykate.